REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.32, datë 20/07/2005

"PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË 12 SHKOLLAVE DHE NDËRTIMIN E 7 SHKOLLAVE TË REJA NË QYTETIN E TIRANËS"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 16, pika 5, neni 19, pika 7/c/III, neni 73, pika 4, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Marrëveshjes së Kredisë së lidhur më dt.09/05/2005 midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.308, dt.28/04/2005 "Për miratimin e kredise për zhvillim dhe rehabilitimin e shkollave në qytetin e Tiranës" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë marrjen e nënhuasë në shumën prej 12.400.000 Euro për realizimin e projektit "Për rikonstruksionin e infrastrukturës arsimore në qytetin e Tiranës" nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, financuar nga Marrëveshja e Kredisë me Bankën e Këshillit të Europës (CEB) dhe miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.308, dt.28.04.2005.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi të bëhet shlyerja e detyrimit të principalit të huasë për shumën prej 12.400.000 Euro pa interesat apo pagesa të tjera. Mënyra e pagesave do të realizohet sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë të nënshkruar midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës.

3. Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë për krijimin e strukturave të nevojshme të parashikuara në Marrëveshjen e Kredisë dhe ndjekjen e realizimit të saj.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI